



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KORÇË**



**Data: 22.07.2024**

### **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROKURIMIT:**

Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Punime ndërtimi për ndërtesa me shumë banesa ose shtëpi individuale 45211000-9

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

**9.146.550 (nëntë milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë)lek,pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **BASHKIA KORÇË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **39% e vlerës** së përlogaritur të kontratës që prokurohet

**Argumentimi:***Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

---

*Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se 39 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".*

**2.2Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 29% e vlerës së përlllogaritur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se 99 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës** që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :**

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten**

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Aktkolaudimi;
4. Fatura tatimore

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 55 pika 4 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 29 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se 99 % e vlerës së përlllogaritur e kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: **”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

**Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

Lidhur me dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e punëve të ngjashme janë kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: **”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”** .

Ne kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit apo marrëveshjes së nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Dokumenta këto të nevojshme për të vlerësuar lidhur me punët konkrete që ka kryer OE si anetar i BOE, apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

*Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme*

**2.2.2-Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:**

<b>Kategoria</b>	<b>Klasifikimi</b>	<b>Emertimi i kategorise</b>
N.P – 1	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P – 3	A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
N.S – 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S- 2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridik që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<b>Kategoria e kërkuar</b>	<b>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</b>	<b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>	<b>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategori në respektive</b>	<b>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>
N.P – 1	Punime gërmimi në tokë.	2. PUNIME DHEU Gërmim dheu me krah e transport k dore 10m, kat III	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve të parashikuara në preventiv dhe që përfshihen në këtë kategori është me e vogël se 20 milion
N.P- 3	Rikonstruktion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale,	PUNIME MURATURE GURI PUNIME MURATURE TULLE PUNIME BETONI DHE B/A PUNIME HEKUR BETONI PUNIME DYER DRITARE PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve të parashikuara në preventiv dhe që përfshihen në këtë kategori

	veshje  fasada bonifikime	PUNIME BOJATISJE PUNIME SHITESASH 2		eshte me e vogel se 20 milion
N.S – 1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje e hidroizolimit ekzistues (tarrace) Prishje mur tulle pa pastrim Prishje çatie ekzistuese me tjegulla Prishje mur guri Prishje suvatim muri i brendshem	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.S- 2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.	INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE F.V lavaman porcelani F.V WC allafrenga F.V bolier 100 l FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16 F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.S-14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefon i TV etj.	INSTALIME PER NDRICIM F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2 F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2 F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2 F.V tub plastmasi Ø 14-17mm F.V Çelesa e priza 10 A F.V Kutiderivacioni plastm	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion

**2.2.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

➤ Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

*Per te vertetuar personelin kryesor duhet:*

*I.diploma*

*II- kontrata e punes*

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**2.2.4.** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** te perfshire ne listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

*2.Teknik ndërtimi 2 (dy)*

Për stafin e sipërcituar të paraqitet

I.Kontrata e punes

II. Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi kerkesat 2.2.3,2.2.4 :** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj”, VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te

zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin kryesor të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

Konkretisht:

Kerkesa per drejtuesin teknik “**Inxhinier Ndertimi**”. Eshte vendosur duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar,pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier,Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuar.

Bazuar ne zerat e punimeve te parashikuara ne preventiv nevojitet nje drejtues teknik me profesion **ing.ndertimi** i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

**Kerkesa per 2 teknikë ndërtimi** - prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike. Tekniket e ndertimit do te jene implementuesi kryesor i rekomandimeve dhe udhezimeve te inxhinierit te ndertimit per sa i perket punimeve ndertimore.

**2.2.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **19 persona**, dokumentuar kjo me Vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi per muajin e fundit te deklaruarnga data e hapjes se ofertave.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.



**2.2.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion me kapacitet mbajtes deri ne 10 ton,me vinc	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Kamion me kapacitet mbajtes deri ne 5 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Betoniere	Cope 3	ne pronesi ose me qira
Vinc stacioner	Cope 2	ne pronesi ose me qira

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike duhet te paraqiten dokumentat si më poshtë :

Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet, certifikata e pronesise , leja e qarkullimit,certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

Kur jane me qera te paraqiten: kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit ,certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit, per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

(Ne rastin e mjeteve te marra me qira nga operatorët ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 , referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,çertifikate e transportit te mallrave ) , mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet)

-Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk shenohen ne regjistra publike ofertuesi duhet te paraqesë dokumente qe vertetojne pronesine e mjeteve/pajisjeve dhe ne rast se jane me qera duhet te kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine e tyre.

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi kriteret 2.2.5 dhe 2.2.6:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç ku përcaktohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit**”

dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se „Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **„mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.“**

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe gjithashtu edhe bazuar edhe në rekomandinë e APP Nr 1797/1 datë 10.03.2022 janë parashikuar orët e punës për secilin zë punimesh dhe bazuar edhe në afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve është përcaktuar numri minimal i punonjësve të domosdoshëm për realizimin e punimeve.

**Numri i fuqisë punëtore është llogaritur në bazë të zberthimit të grafikut të punimeve, zberthimit të preventivit dhe natyrës së objektit, numri prej 19 personash përfshin personelin kryesor drejtues teknik, staf mbështetës, specialiste+punëtorë (karpentierë, muratorë, suvaxhi, hidraulik, elektrikist, punëtorë të thjeshtë) të përlogaritur nga zberthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.**

**Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushës rezultojnë se :**

Sasia totale e orëve të punës sipas manualit dhe analizave teknike për çdo zë të preventivit është **8320** orë. Llogaritja e numrit të punonjësve në varesi të orëve të punës dhe afatit të kontratës është si më poshtë:

Totali orë pune + orë makineri	<b>8320</b>
Ditë pune (orë pune/8)	1040
Specialiste+punëtore për 3 muaj	16
Ing. ndërtimi	1
Teknik ndërtimi	2
Numri i punëtorëve gjithsej	<b>19</b>

**Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike:**

*Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës Ky kriter u vendos duke patur parasysh natyrën dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv .*

*Gjithashtu bazuar në nenin 28 të Udhëzimit Nr.15, datë 24.7.2007 "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR"i ndryshuar, "Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit."*

<b>Lloji i Makinerive</b>	<b>Sasia</b>	<b>Argumentimi</b>
Kamion me kapacitet mbajtes deri ne 10 ton,me vinc	Cope 2	Nevojiten per transportin dhe vendosjen ne vend te materialeve ndertimore dhe tjegullave. Janë parashikuar punime ne disa objekte të shpërndara ne territor
Kamion me kapacitet mbajtes deri ne 5 ton	Cope 1	Nevojitet per transportin me materialeve te ndryshme si pllaka,dyer dritare,cimento,tulla dhe rere.
Betoniere	Cope 3	Nevojiten per pergatitjen e llacit per muratura dhe pergatitjen e llustres te cimentos per taracat. Janë parashikuar punime ne disa objekte të shpërndara ne territor
Vinc stacioner	Cope 2	Nevoiten per ngritjen dhe vendosjen ne vend te materialeve per hidroizolimn e taracave ne objektet me 5 kate.

**Argumentimi i specifikimeve teknike**

Dokumentacioni teknik ku përfshihen Specifikimet Teknike,Projekti, Preventivi dhe Grafiku i Punimeve për këtë objekt janë dorëzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës , pjesë e bashkësive të bashkuara të Bashkisë Korçë, në përputhje me detyrat e saj funksionale.

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(e ndryshuar).

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi , burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Gjate hartimit te specifikimeve teknike jane marre ne konsiderate kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te percaktuara ne aktet ne ligjore ne fuqi ne fushen e ndertimit.

Specifikimet teknike jane sipas materialit i cili eshte publikuar sebashku me dokumentat e tenderit.

## **NJESIA E PROKURIMIT**